

# E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

## Fokusi i muajit

### Procedurat për shqyrtimin e ankesave

Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga Ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.

Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.

Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t'u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.

## Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

**Vendim nr. 10** - Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

**Vendim nr. 11** - Agjencia Kombëtare e Mjedisit

**Vendim nr. 12** - Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë

**Vendim nr. 13** - Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit

**Vendim nr. 14** - Për mospranimin e ankesës, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

**Vendim nr. 15** - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

**Vendim nr. 17** - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

**Vendim nr. 18** - Bashkia Elbasan

# Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), gjatë muajit mars, ka dhënë 9 vendime në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI).

Me anë të Vendimit nr. 17, datë 19.03.2021, KDIMDP ka pranuar ankesën ndaj Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) ku kërkohej numri i rekurseve në Gjykatën e Lartë të bëra nga OSHEE gjatë viteve 2014 - 2020 si dhe numri i kërkesave për pezullim ekzekutim vendimi të bëra nga autoriteti publik para Gjykatës së Lartë për vitet më sipër.

Në ndjekje të procedurave administrative me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, KDIMDP ftoi palët në një seancë dëgjimore.

Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar pranë KDIMDP, në prani të dy palëve, përfaqësuesit e OSHEE rikonfirmuan qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore sipas së cilave "Informacioni i kërkuar nuk është informacion publik por informacion i brendshëm i shoqërisë OSHEE, informacion i cili është rezultat i veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Ky informacion mund të raportohet pranë organeve si Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e aksionerit të shoqërisë OSHEE, Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë, Auditi i Brendshëm i shoqërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, si dhe me organet e hetimit dhe gjykimin sipas vendimeve dhe kërkesave përkatëse."

Gjithashtu, gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesit e Autoritetit Publik sqaruan ndër të tjera se: "...dokumenti i kërkuar nuk konsiderohet dokument zyrtar pasi nuk plotëson elementët e përcaktuar ligjor, sipas pikës 3 të nenit 3 të LDI. Në kuptim të kësaj dispozite, ky informacion nuk disponohet në formën e kërkuar, por duhet të përpunohet. Ankuesi, këtë informacion, mund t'a marri në Gjykatën e Lartë..."

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE  
PUBLIKE ËSHTË PARADHOMA  
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

## #informim #transparencë #vendim

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerësoi se argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit nuk qëndrojnë.

OSHEE është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës, pavarësisht se informacioni i prodhuar është si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Legjislacioni i mësipërm nuk parashikon përjashtimin e OSHEE nga zbatimi i detyrimeve që burojnë nga LDI.

Lidhur me pretendimin se nuk ekziston një dokument statistikor bazuar në kërkesën për informacion, por duhet prodhuar një dokument i ri, KDIMDP vlerësoi se këto dokumente, përbëjnë informacion publik dhe bazuar në dispozitat e sipërcituara duhet të vendosen në dispozicion të kërkuarit/ankuesit në formatin e disponuar (duke mbajtur në konsideratë kufizimet sipas nenit 17 të LDI).

Në përfundim të procesit administrativ të shqyrtimit të ankesave KDIMDP vendosi Urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit të kërkuar.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP [www.idp.al](http://www.idp.al).

# Zyra e Komisionerit bashkëpunon me organizatën Roma Veritas Albania

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbështet organizatën Roma Veritas Albania, në kuadër të projektit të saj “Edukimi ligjor i studentëve rom, mediatorëve komunitar dhe të shëndetit për të lehtësuar aksesin në drejtësi për komunitetin e tyre”.


Ky bashkëpunim u fokusua në zhvillimin e trajnimit me studentë dhe pjesëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian, për njohjen me të drejtat kushtetuese të aksesit në informacionin me karakter publik dhe atë të mbrojtjes së privatësisë e të dhënave personale.

Në këtë aktivitet të pranishmit u njohën me legjislacionin në të dy fushat e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit, me funksionet dhe rolin e institucionit dhe me raste praktike të adresuar apo ku përfshihen pjesëtarë të këtij komuniteti.

Lektore në këtë aktivitet ishin znj. Elona Hoxhaj - Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit të Ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit dhe znj. Pjerina Gaxha - Drejtor i Drejtorisë së Ankesave dhe Harmonizimit në Drejtorinë e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Bashkëpunimi me organizatën RVA do të shtrihet edhe në veprimtari të tjera me interes të ndërsjellët.


Zyra e Komisionerit mirëpret dhe është e gatshme të bashkëveprojë me çdo organizatë të shoqërisë civile që nxit dhe forcon zbatimin e të drejtave të qytetarëve dhe pjesëmarrjen e tyre në funksion të mirëqeverisjes.



**1. Hartimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale**

**Ligji nr. 10.03.2008 "Për të Dhënave Personale"**  
hartuar sipas 95/46 dhe referencave të BE.

**Lidhja e bashkëpunimit me institucionet private, që ligji i kontrollues e Përpunues.**



**INFORMACIONI MBI DREJTËN E TË DHËNAVE PERSONALE**  
NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME PËR TË DHËNAVE PERSONALE

**Rastet, për të dhënave personale që janë dhe vlerë e bashkëpunimit**  
Planit (organizatave për të dhënave personale)  
Drejtoria, organizatave  
\*Mbrojtja e informacionit të performancës së prodhuesit (në vend dhe jashtë)  
\*Të dhënave personale të informacionit shkollor  
\*Informacioni që shërben qëllimeve të tjera të informacionit të bashkëpunimit

**INFORMACIONI PËR PROCEDURAT E PROBLEMEVE PROCEDURAT KONKURRËNCE TË**  
NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME PËR TË DHËNAVE PERSONALE

**Lidhja e bashkëpunimit me**  
Regjistrat e shtetit, të informacionit sipas parashkrimit ligjor  
Regjistrat e informacionit të prodhuesit publik  
Informacioni në informacionin e bashkëpunimit  
Regjistrat / parashkrimit të prodhuesit publik / përditësuar

# Transparenca proaktive, përgjegjësi e Autoriteteve Publike

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (LDI), me Urdhërat nr. 187 dhe nr. 188, datë 18.12.2020, miratoi modelet e reja të Programit të Transparencës dhe Regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve. Afati për Autoritetet Publike për publikimin e këtyre formateve të rishikuara ishte brenda datës 31 mars 2021.

Gjatë kësaj periudhe, me iniciativën e Zyrës së Komisionerit janë zhvilluar takime me koordinatore për të drejtën e informimit të institucioneve qendrore e të varësisë dhe atyre të pavarura, për t’i asistuar për publikimin e Programit të Transparencës dhe Regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve sipas formës dhe përmbajtjes së modeleve të rishikuara. Nga ky proces konsultimi, Zyra e Komisionerit mori në konsideratë vështirësitë që kanë hasur Autoritetet Publike me situatën e pandemisë COVID-19, por janë konstatuar edhe problematika të karakterit tekniko-organizativ për të vënë në funksion modelet e rishikuara të këtyre dokumenteve.

Për këto arsye, Komisioneri, me Urdhërat nr. 35 dhe nr. 36, datë 31.03.2021, ka vendosur shtyrjen e afatit të sipërpërmendur deri më 30 qershor 2021. Çdo Autoritet Publik duhet të marrë masat e domosdoshme për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor.

